



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 21, datë 28.07.2020

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“RESORT TURISTIK “DREAMADES LUXURY SUITS”, 1-2-3 KATE MBI TOKË DHE
2 KATE NËNTOKË, ME VENDNDODHJE FSHATIN GJILEKË, BASHKIA HIMARË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “AG. TCC” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Resort turistik “Dreamades Luxury Suits”, 1-2-3 kate mbi tokë dhe 2 kate nën tokë, me vendndodhje në fshatin Gjilekë, Bashkia Himarë”, me subjekt zhvillues “AG. TCC” sh.p.k., sipas Lejes së Zhvillimit të miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 15, datë 10.06.2020.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

